

FUQIA DHE TENSIONET
E VETËVENDOSJES

FAQE 4-5



Sot, kur është në kulmin e pushtetit, Lëvizja Vetëvendosje përballet me sfida të brendshme dhe të jashtme: kritika për stilin e qeverisjes, dilema mbi raportet me aleatët ndërkombëtarë dhe, së fundi, sinjale përçarjeje brenda strukturave të saj. E ato u bënë të dukshme në fillim të kësaj jave, kur ministri i Mjedisit, Liburn Aliu, nga radhët e Vetëvendosjes, dha dorëheqje pas zgjedhjes së bashkëpartiakut të tij, Dimal Basha, në krye të Kuvendit të Kosovës

HAZIRI PËR
KONSTITUIMIN
E KUVENDIT:
ME RËNDËSI
QË AGJENDA E
FSHEHUR PO ECËN

F. 7



GJASHTË
OFICERË TË FSK-së
DIPLOMOJNË
ME SUKSES NË
AKADEMINË
USHTARAKE
TË TURQISË

F. 3



OPINION

SHQIPTARËT MES POLITIKËS
DHE ZHVILLIMIT

F. 9

Shkruan:
Nazmi JUSUFI



PËR PAK FAMË AKADEMIKE
U ZHYTËN NË QARQE
ALBANOFUBE DHE ISLAMOFUBE

F. 6

Shkruan: Besa
ISMAILI-AHMETI,
profesoreshë dhe ish-deputete
e Kuvendit të Kosovës



AKTUALE



STUHI E FUQISHME GODET GREQINË
PERËNDIMORE

F. 2

KINA DHE INDIA ZOTOHEN TË JENË
PARTNERE E JO RIVALE

F. 2

EKONOMI



"ALARMANTE", SHUHEN RRETH
700 BIZNESE. JA FAKTORËT QË
ÇUAN DREJT FALIMENTIMIT

F. 8

MBI NJË MILION TË PUNËSUAR MË
2024 NË SHOIPËRI, PJESA MË E
MADHE NË TURIZËM DHE BUJQËSI

F. 8

RENOVA
PUTZ

Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

**PRINCESHA**
GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**
FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Kina dhe India zotohen të jenë partnere e jo rivale

PEKIN, 31 GUSHT - Presidenti i Kinës, Xi Jinping, dhe kryeministri i Indisë, Narendra Modi, janë zotuar të dielën për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet kufitare dhe për ta forcuar bashkëpunimin para hapjes së një samiti rajonal në Tianjin. Modi po e viziton Kinën për herë të parë që prej përkeqësimit të marrëdhënieve mes dy vendeve pas përplasjes vdekjeprurëse mes ushtarëve kinezë dhe indianë në kufi në vitin 2020. Ai ndodhet në Kinë si pjesë e anëtarësimit të Indisë në Organizatën e Shangait për Bashkëpunimi, e cila është grupim rajonal politik, ekonomik dhe i sigurisë i themeluar nga Kina. Në fjalën e tij hapëse, Modi tha se marrëdhëniet me Kinën janë

zhvendosur në “një drejtim domethënës”, duke shtuar se “në kufi mbizotëron tani një mjedis paqësor pas ndaljes së mospajtimeve”. Xi tha se shpreson që takimi në Tianjin “do ta çojë më lart” dhe do ta promovojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të shëndetshëm të marrëdhënieve dypalëshe”, sipas transmetuesit shtetëror CCTV. Të dyja palët nuk duhet “ta lënë çështjen kufitare ta përcaktojë marrëdhënien e përgjithshme Kinë - Indi”, shtoi Xi, duke theksuar se zhvillimi ekonomik për të dyja vendet duhet të jetë përqendrimi kryesor. “Për sa kohë që mbeten të përkushtuar ndaj synimit të përgjithshëm për të qenë partnerë, jo rivalë, dhe për të ofruar mundësi zhvillimi,



jo kërcënime, marrëdhëniet Kinë - Indi do të lulëzojnë dhe do të ecin përpara në mënyrë të qëndrueshme”, tha Xi. Ndërkohë, presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, i cili mbërriti në

Tianjin të dielën, pritet të takohet me të dy liderët në ditët në vijim. Në fillim të gushtit, diplomati i lartë kinez, Wang Yi, vizitoi Nju-Delhin, ndërsa të dyja palët

shpallën afrim të marrëdhënieve. Të dyja qeveritë u zotuan t'i rinisin bisedimet kufitare si dhe ta rifillojnë lëshimin e vizave dhe fluturimeve direkte. Vizita e Wangut përkoi me vendimin e presidentit amerikan Donald Trump për të vendosur tarifa prej 50-përqindësh ndaj Indisë për blerjen e naftës ruse, por procesi i Delhit për t'i rindërtuar marrëdhëniet me Pekinin kishte qenë në përgatitje prej muajsh. Këtë vit Kina dhe India kanë shtuar vizitat zyrtare dhe kanë diskutuar për lehtësimin e disa kufizimeve mbi tregtinë dhe lëvizjen e njerëzve përtej kufirit. Në qershor Pekini lejoi pelegrinët nga India t'i vizitojnë vendet e shenjta në Tibet.

Rusia godet rrjetin energjetik të Ukrainës, lë mijëra banorë pa rrymë

ODESA, 31 GUSHT - Rusia i ka vazhduar bombardimet e pamëshirshme kundër Ukrainës të dielën, duke i goditur objektet e energjisë në të paktën dy rajone dhe duke shënjestruar disa lokacione të tjera në të gjithë vendin. Sulmet me dronë dëmtuan katër objekte energjetike në rajonin e Odesës mëngjesin e së dielës, duke lënë pa rrymë më shumë se 29 000 banorë, tha në Telegram kreu rajonal Oleh Kiper. Kiper shtoi se sulmet ruse dëmtuan gjithashtu shtëpi private dhe ndërtesa të tjera dhe se një person u plagos. “Infrastruktura kritike po furnizohet përmes gjeneratorëve”, tha Kiper, duke shtuar se qyteti bregdetar Çernomorsk, në jug të Odesës, u godit më së rëndi. Një sulm me dronë disa orë më vonë goditi infrastrukturën civile energjetike në rajonin e Çernihivit në Ukrainën veriore, duke lënë pa energji elektrike 30 000 familje në qarkun Nizhin, tha guvernatori rajonal Vjacheslav Chaus. Ai tha se furnizimi me rrymë është



rikthyer për spitalin kryesor dhe sistemin e ujit të qytetit. Sulmet e reja ndodhën teksa aleatët e një politikani të njohur ukrainas, i vrarë me armë zjarri një ditë më parë në qytetin perëndimor të Lvivit, fajësuan Rusinë, ndërkohë që presidenti rus, Vladimir Putin, mbërriti në Kinë për takimin vjetor të një organizate rajonale që përfshin gjithashtu Kinën, Indinë dhe shtatë vende të tjera. Në mbarë vendin mbrojtja

ajrore rrëzoi 126 nga 142 dronët e zbuluar gjatë natës, ndërsa dronë të tjerë goditën në 10 lokacione, tha Forca Ajrore e Ukrainës. Breshëria e sulmeve pasoi ato në rajonin verilindor të Sumit, në kufi me Rusinë, të shtunën, ku një zyrtar i lartë i një fshati u plagos, njoftuan autoritetet. Putini pritet të takohet me liderët e Kinës, të Indisë dhe të tjerë në samitin e Organizatës së Shangait për Bashkëpunim,

që mbahet të dielën dhe të hënën në Tianjin, Kinë, mes tensioneve me Perëndimin për pushtimin e Ukrainës dhe çështje të tjera. Që nga fillimi i pushtimit të plotë të Ukrainës në shkurt 2022, Kina ka qenë partnere vendimtare për Rusinë, duke ushqyer ekonominë e saj të luftës përmes blerjes së naftës dhe gazit, duke furnizuar artikuj me përdorim të dyfishtë për arsenalin e saj ushtarak

përballë sanksioneve perëndimore, si dhe duke i dhënë Moskës mbështetje diplomatike në arenën ndërkombëtare. Andriy Parubiy, deputet nationalist dhe ish-kryetar i Parlamentit, u vra me armë në mes të ditës në një rrugë pranë shtëpisë së tij më 30 gusht. Derisa autoritetet e sigurisë po përpiqen ta gjejnë dhe ta kapin dorasin, si dhe të zbulojnë të dhëna mbi motivin e mundshëm të vrasjes, disa bashkëpunëtorë të Parubiy fajësuan Rusinë. Deputeti Mykola Knyazhyskiy tha se besonte se vrasja e Parubiy ishte “hakmarrje ruse për qëndrimin e tij”, duke sugjeruar se ai ishte shënjestruar për mbështetjen e tij ndaj sovranitetit, sigurisë dhe unitetit të Ukrainës përballë pushtimit rus. “Kjo është një vrasje [e menduar] për të frikësuar dhe shkatërruar ata njerëz që janë liderë të vërtetë, të fortë dhe të përgjegjshëm ukrainas, në mënyrë që kombi ukrainas të mos ketë të ardhme”, tha Knyazhytskiy.

Stuhi e fuqishme godet Greqinë perëndimore

Athinë, 31 gusht - Stuhia e fuqishme që goditi Greqinë perëndimore la pas shkatërime të mëdha në disa qytete, me dëmet më të rënda të regjistruara në Korfuz, Kostur, Grevena, Kozan dhe Janinë. Në Korfuz brenda vetëm

një ore ranë 126 milimetra shi, duke e kthyer qytetin në një liqen. Rrugët u përmytën, dyqane u dëmtuan rëndë në zonën e Spilias, ndërsa rruga drejt aeroportit u bë e pakalueshme për orë të tëra. Probleme të mëdha pati edhe

në qarkullimin ajror, pasi 29 fluturime u anuluan ose devijuan në Aktio, Selanik e Janinë. Ndërkohë, Kasturi u përball me një stuhi të papritur që shkaktoi dëme të mëdha në kulturat bujqësore dhe në qytet. Era me

shpejtësi mbi 100 km në orë shkuli pemë, shkatërroi prodhimin e fasuleve dhe mollëve, ndërsa qindra familje mbetën pa energji për orë të tëra. Disa automjete u dëmtuan kur pemët ranë mbi to, ndërsa rrugë të tëra u bllokuan.



Haziri për konstituimin e Kuvendit: Më rëndësi që agjenda e fshehur po ecën

PRISHTINË, 31 GUSHT - Deputeti i LDK-së, Lutfi Haziri, duke e komentuar situatën politike në vend, ka thënë se Republika është mbi të gjitha. Sipas tij, po bëhet politikë 'një hap para e dy prapa' edhe në rastin e konstituimit të Kuvendit.

Ai ka thënë se kur të gjithë besonin që me zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve të shumicës politike e etnike, u bë një hap para, ndodhi veprimi. "Ndarja e zgjedhjes së nënkryetarëve të pakicave dhe dy hapa prapa. Asgjë e re. Më rëndësi që agjenda e

fshehur po ecën", ka shkruar ai në "Facebook". Haziri ka thënë se këta s'e kuptojnë ose nuk duan ta kuptojnë frymën e Kushtetutës që bashkëpunimi është obligativ e jo vullnet. "Pragmatizmi politik e kompromisi janë vlera në

politikë e jo dobësi. Sa i përket të drejtave për komunitetet pakicë në Kosovë edhe vetë jam bindur tash se pse miqtë ndërkombëtarë na kërkonin që t'i bënim e garantonim vetëm me mekanizma kushtetues. Republika, mbi të gjitha!", ka thënë Haziri.



BIZNESMENI SHAHIN DERVISHAJ: MË 14 SHTATOR, KRAH PËR KRAH ME HERONJTË TANË NË HAGË

PRISHTINË, 31 GUSHT - Biznesmeni, anëtar i KD të PDK-së, Shahin Dervishaj, ka bërë thirrje për t'i dhënë mbështetje protestës për çlirimtarët që do të mbahet më 14 shtator në Hagë.

Ai përmes një postimi në "Facebook" ka shkruar se më 14 shtator, zemrat dhe zërat tanë bashkohen në Hagë për të mbrojtur dinjitetin e çlirimtarëve tanë.

Dervishaj ka thënë se kjo protestë është thirrje për unitet kombëtar, për të vërtetën historike dhe për të mos lejuar që të shtrembërohet lufta e drejtë e popullit tonë. "Mbështetje për Çlirimtarët tanë. Protesta në Hagë, 14.09.2025. Më 14 shtator 2025, zemrat dhe zërat tanë bashkohen në Hagë për të mbrojtur dinjitetin e çlirimtarëve tanë. Ata që

sakrifikuan gjithçka për lirinë e Kosovës, meritojnë respekt, nderim dhe drejtësi. Kjo protestë është thirrje për unitet kombëtar, për të vërtetën historike dhe për të mos lejuar që të shtrembërohet lufta e drejtë e popullit tonë. Ne qëndrojmë krah për krah me heronjtë tanë, sepse liria ka emër dhe ajo është sakrificë e tyre. Drejtësi për çlirimtarët!", ka shkruar afaristi Dervishaj.



GJASHTË OFICERË TË FSK-së DIPLOMOJNË ME SUKSES NË AKADEMINË USHTARAKE TË TURQISË



PRISHTINË, 31 GUSHT - Në Akademinë Ushtarake të Turqisë, u diplomuan me sukses gjashtë oficerë të rinj të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Adrian Ukiqi, Fatlind Neziri, Getoar Berisha, Hamdi Hasani, Shefit Tahiri dhe Dardane Mehmeti. Oficerët e rinj të FSK-së përfunduan me sukses një program pesëvjeçar studimesh, i cili përfshiu një kombinim të formimit ushtarak dhe akademik civil. Në kuadër të këtij programi, ata

kanë kryer ushtrime intensive në terren, kanë përvetësuar njohuri të avancuara ushtarake dhe kanë zhvilluar aftësi në lidhshmëri, strategji dhe menaxhim. "Përveç studimeve teorike dhe akademike, kadetët kanë kryer me sukses ushtrime të avancuara në terren në kampin ushtarak të Izmirit, ku janë trajnuar në taktika, operacione luftarake dhe menaxhimin e situatave reale", bën të ditur ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci.

Një pjesë e rëndësishme e formimit të tyre ka qenë edhe përfundimi me sukses i Kursit të Komandos në Isparta "Dağ Komando Okulu", një nga shkollat më prestigjioze dhe sfiduese për trajnim të forcave elitare. Gjatë këtyre pesë viteve, oficerët e rinj kanë fituar njohuri të thelluara në fusha ushtarake dhe akademike, duke u përgatitur të marrin rol aktiv në misionet dhe përgjegjësitë që i presin në kuadër të FSK-së.

MBI 1 MILION TË PUNËSUAR NË 2024 NË SHQIPËRI, PJESA MË E MADHE NË TURIZËM DHE BUJQËSI



TIRANË, 31 GUSHT - Gjatë vitit 2024, në Shqipëri ishin afro 1.2 milion persona të punësuar. Në krahasim me vitin 2023, numri është rritur me 2%, ndërsa të papunë kishte 110 mijë persona. Sektori i shërbimeve dhe sektori bujqësor kishin përqindjen më të lartë të të punësuarve, ndërsa

qarqet me shkallë punësimi më të lartë ishin Kukësi dhe Gjirokastra, shkruan Euronews.al. Nga ana tjetër, Lezha dhe Vlora kishin shkallën më të ulët të punësimit. Analiza e INSTAT nxjerr edhe pagën mesatare bruto në shtet

dhe privat, e cila vitin e kaluar ishte 77 mijë e 500 leke, me rritje vjetore rreth 10%. Të punësuarit me paga më të larta në vendin tonë, vitin e kaluar ishin menaxherët, ligjvënësit, nëpunësit e lartë të administratës shtetërore, drejtuesit në Forcat e

Armatosura apo edhe të punësuarit në sektorin e Informacionit dhe Komunikacionit. Ndërsa më pak të paguarit ishin ata që punuan në bujqësi, zejtarët, artizanët dhe të punësuarit në transport e magazinim.

Në ditëlindjen e heroit Bahri Fazliu, Haradinaj bën homazhe në vendin e rënies

PRISHTINË, 31 GUSHT - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe te pllaka përkujtimore e Bahri Fazliut në trekufirin ku ai ra heroikisht para 27 vitesh. Haradinaj e cilësoi Fazliun si intelektual, vizionar dhe trim të

pashoq, shembull i përkushtimit për vendin. "Heroi Bahri Fazliu, si intelektual, vizionar e trim i pashoq, ishte shembull se si duhet Atdheu e luftohet për të. Në ditëlindjen e tij, me shumë bashkëluftëtarë, bëme nderime

te pllaka përkujtimore kushtuar Bahri Fazliut, pikërisht në vendin ku u përjetësua para 27 vitesh, te trekufiri. Lavdi Bahri Fazliut dhe gjithë dëshmorëve që ranë duke mbrojtur nderin e luftëtarit shqiptar!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".





FUQIA DHE TENSIONET E VETËVENDOSJES

Sot, kur është në kulmin e pushtetit, Lëvizja Vetëvendosje përballlet me sfida të brendshme dhe të jashtme: kritika për stilin e qeverisjes, dilema mbi raportet me aleatët ndërkombëtarë dhe, së fundi, sinjale përçarjeje brenda strukturave të saj. E ato u bënë të dukshme në fillim të kësaj jave, kur ministri i Mjedisit, Liburn Aliu nga radhët e Vetëvendosjes, dha dorëheqje pas zgjedhjes së bashkëpartiaktut të tij, Dimal Basha, në krye të Kuvendit të Kosovës.

Prishtinë, 31 gusht - Dy dekada pas themelimit, Lëvizja Vetëvendosje duket se po përjeton edhe një dridhje politike, me anëtarë “të rebeluar”, vërejnë analistët. Nga një lëvizje e pavarur opozitare, që nisi me protesta të fuqishme kundër kompromisit politik dhe ndërhyrjeve ndërkombëtare, ajo u shndërrua në partinë më të madhe në Kosovë. Por, sot,

kur është në kulmin e pushtetit, përballlet me sfida të brendshme dhe të jashtme: kritika për stilin e qeverisjes, dilema mbi raportet me aleatët ndërkombëtarë dhe, së fundi, sinjale përçarjeje brenda strukturave të saj. Vetë partia nuk iu përgjigj kërkesës së “Radios Evropa e Lirë” për të komentuar mbi ndarjet mes anëtarëve të saj. E ato u bënë të dukshme në

fillim të kësaj jave, kur ministri i Mjedisit, Liburn Aliu nga radhët e Vetëvendosjes, dha dorëheqje pas zgjedhjes së bashkëpartiaktut të tij, Dimal Basha, në krye të Kuvendit të Kosovës. “Konsideroj se zgjedhja e kryetarit të Kuvendit - institucionit më të lartë, ku vendosen ligjet dhe jep llogari qeveria - nuk është në frymën e në lartësinë e atij ideali për Republikën që ka qenë dhe mbetet arsye angazhimi për mua”, tha Aliu. Basha u kundërpërgjigj duke thënë vetëm se e “çmon kontributin e tij si aktivist në Lëvizjen Vetëvendosje”, por edhe punën e tij si ministër. Ai tha se pakënaqësitë janë “të natyrshme”. Edhe udhëheqësi i Vetëvendosjes, Albin Kurti, tha shkurtimisht se e

“falënderon ish-ministrin Liburn Aliu për kontributin”. Përkundër përpjekjeve, “Radio Evropa e Lirë” nuk arriti të bjerë në kontakt me Aliun.

Basha - vetëm shkas për “rebelimin” e Aliut

Njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë se zgjedhja e Bashës kryeparlamentar ka shërbyer vetëm si shkas për dorëheqjen e njërit prej themeluesve të Vetëvendosjes nga posti ministror. Sipas tyre, pas këtij vendimi mund të fshihen edhe arsye të tjera që Aliu nuk i ka bërë publike. Rrahman Paçarizi, profesor në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, beson se dorëheqja e tij pasqyron mospajtimin me politikën e partisë, që e kanë

shtyrë “drejt rebelimit”. “... mirëpo, kjo nuk ka qenë arsyeja themelore; thjesht, momenti kur kupa është mbushur dhe nuk ka mbajtur më”, thotë Paçarizi për “Radion Evropa e Lirë”. Edhe analisti Imer Mushkolaj, duke iu referuar burimeve brenda Vetëvendosjes, thotë se dorëheqja e Aliut nuk lidhet vetëm me zgjedhjen e Bashës, por edhe me rezervat e tij ndaj disa vendimeve dhe drejtimeve të partisë. “Është një shprehje e pakënaqësisë me mënyrën se si Vetëvendosje ka operuar deri më tash në qeverisje, ndonëse edhe zoti Aliu ka qenë pjesë e qeverisjes”, thotë Mushkolaj për “Radion Evropa e Lirë”. Ai shpjegon se pakënaqësitë mund të lidhen me largimin e Kurtit nga ideologjia dhe parimet me të cilat e kishte

ndërtuar Vetëvendosjen, si dhe me premtimet e pambajtura gjatë pushtetit. Që nga ardhja në qeveri në fillim të vitit 2020 dhe më pas në vitin 2021, Mushkolaj thotë se partia ka lënë mënjanë narrativëve për bashkimin me Shqipërinë, nuk ka ndërmarrë një luftë të pakompromis kundër korrupsionit dhe nuk e ka trajtuar dialogun me Serbinë si një prioritet të ulët - ndonëse këto i kishte premtuar më herët.

“Këto nuk përmenden më si kushte ose si parime për të shkuar tutje. Ndaj konsideroj se pakënaqësitë për këto çështje, pavarësisht që mund të zbuten nga të qenët në pushtet, nuk mund të evitohen plotësisht”, thotë Mushkolaj. Ai kujton se Aliu nuk mori pjesë në zgjedhjet e brendshme të Vetëvendosjes në vitin 2022 dhe nuk ishte as në listën e deputetëve për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit - edhe pse Aliu kishte deklaruar se ishte vendim i tij personal për të mos marrë pjesë.

Largimet e ish-udhëheqësve

Kjo nuk është hera e parë që Lëvizja Vetëvendosje përballet me dezertime të nivelit të lartë. Në vitin 2018 ajo përballoi një periudhë të tensionuar politike dhe përplasje të brendshme që tronditën strukturat e saj drejtuese. Konfliktet kulmuan me

dorëheqjen e disa prej figurave kryesore të partisë, duke përfshirë ish-kryetarin Visar Ymeri, ish-sekretarin organizativ Dardan Molliqaj, nënkryetarin Dardan Sejdiu si dhe zyrtarë të tjerë: Shpend Ahmeti, Ilir Deda, Frashër Krasniqi, Belgzim Kamberi e Aida Dërguti. Shumica e tyre më pas krijuan Partinë Socialdemokrate, megjithëse disa nga ta u larguan më vonë edhe nga kjo parti.

“Radio Evropa e Lirë” tentoi të kontaktonte disa prej tyre për të marrë koment mbi zhvillimet brenda Vetëvendosjes atëherë dhe tash.

Ymeri, Ahmeti dhe Sejdiu nuk ishin të qasshëm, ndërsa Dërguti nuk shprehu vullnet për të komentuar.

Kamberi, dikur anëtar i Kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se dorëheqja e Aliut - njërit prej bashkëpunëtorëve më të hershëm dhe më të afërt të Kurtit - nuk është e zakonshme. “Nuk është njëjtë kur krisin marrëdhëniet me dikë si Liburn Aliu sikur me një deputet apo aktivist tjetër... Liburni ka qenë dhe mbetet një person i rëndësishëm për Lëvizjen Vetëvendosje, për historikun e saj”, thotë ai.

“Kurti vendos gjithçka”

Kamberi shton se partia ka mekanizma ‘pro forma’, apo formalë, për menaxhimin e

mospajtimeve, për t’u mundësuar anëtarëve dhe strukturave drejtuese t’i shprehin ato dhe për të dhënë një pamje se debatet adresohen.

Megjithatë, thekson ai, diskutimet reale brenda partisë mbahen larg syrit të publikut. “Ajo që ndodh zakonisht është se kur lideri [Kurti] e sheh të rrezikuar popullaritetin e tij personal, por edhe atë të Vetëvendosjes, nga ndonjë përplasje e brendshme ose mosmarrëveshje, atëherë mund të ndërmerren strategji të ndryshme. Siç e kemi parë, të demonizohen, për shembull, personat që nuk pajtohen”, thotë Kamberi.

Paçarizi vlerëson se aktualisht nuk ka rrezik që ndonjë reagim i brendshëm ta kërcënojë funksionimin e partisë apo pozicionin e liderit të saj, Albin Kurti. “Ky grup politik është një ‘one man show’, ku gjithçka vendoset nga zoti Kurti”, thotë Paçarizi. “Kushdo [nga Vetëvendosje] që i kundërvihet zotit Kurti shkon në margjinat politike të Kosovës dhe dalëngadalë bëhet i parëndësishëm, në kuptimin e aktivitetit politik brenda çfarëdo partie politike”, shton ai.

Si mund të reagojë elektorati?

Kurti u bë kryeministër për herë të parë në shkurt të vitit 2020, qeveria e tij u rrëzua shpejt, duke u bërë më

jetëshkurtra pas luftës në Kosovë. Konfliktet mbi menaxhimin e pandemisë Covid-19 dhe dialogun me Serbinë u përshkallëzuan deri në mocionin e mosbesimit të ngritur nga Lidhja Demokratike e Kosovës më 25 mars të atij viti, e që çoi në kolapsin e Qeverisë.

Më pak se një vit më vonë, në shkurt të vitit 2021, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare, ku Lëvizja Vetëvendosje arriti të sigurojë mbi 50 për qind të votave, duke rifituar fuqinë qeverisëse me një mandat të fortë popullor.

Vetëvendosje doli e para edhe në zgjedhjet e fundit, më 9 shkurt, ndonëse me përqindje më të vogël të votave: 42.3 %.

Mushkolaj vlerëson se tash për tash Vetëvendosja pritet të jetë e kujdesshme para elektoratit të saj. “Tensionet ose maspajtimet brenda Lëvizjes Vetëvendosje ekzistojnë edhe tash. Mund të shkojnë duke u rritur, por konsideroj që edhe një mandat në pushtet i Vetëvendosjes - me kryeministër Kurtin - do të arrijë që pak a shumë, jo t’i shuajë tensionet, por t’i mbajë të heshtura deri në një moment të dytë”, thotë ai.

Edhe sipas Paçarizit, ky elektorat i Vetëvendosjes “beson në Kurtin”. “Janë votues, të cilët janë ‘besimtarë’... [Kurti] është një lloj udhëheqësi shpirtëror i atij grupi të njerëzve të cilët e votojnë pa pasur nevojë për

shpjegime apo për arsyetime se pse duhet ta votojnë. Thjesht, janë të bindur që duhet ta votojnë dhe e votojnë”, thotë Paçarizi.

Kurti prej muajsh është kryeministër në detyrë, pasi Kuvendi i Kosovës, që do t’i hapte rrugë formimit të qeverisë së re, nuk është konstituuar ende plotësisht.

Gjatë katër vjetëve të fundit qeveria e tij e ka gjetur veten në raporte të Departamentit amerikan të Shtetit për korrupsion qeveritar, apo të Reporterëve pa Kufij për kufizimin e lirisë së medieve. Por, ajo që ka përcaktuar më thellësisht qeverisjen e kryetarit të Vetëvendosjes ka qenë vendosmëria e tij për ta zgjeruar autoritetin e Kosovës në veri të vendit, ku popullata shumicë është serbe dhe, me vite, nuk u është bindur vendimeve të Prishtinës zyrtare.

Vendimet për instalimin e kryetarëve shqiptarë në komunat me shumicë serbe, për zëvendësimin e targave serbe të makinave, për heqjen nga përdorimi të dinarit serb dhe për mbylljen e shumicës së institucioneve të Serbisë - edhe pse qenësore për vizionin e Kurtit për një Kosovë sovranë dhe të bashkuar - kanë pasur kosto të lartë mbi aleancat ndërkombëtare.

Si rrallëherë në publik, zyrtarët e BE-së dhe të ShBA-së e kanë kritikuar ashpër qeverisjen e tij, duke i përshkruar veprimet e saj si të pakoordinuara.



PËR PAK FAMË AKADEMIKE U ZHYTËN NË QARQE ALBANOFUBE DHE ISLAMOFUBE

Sa jemi te “studimet” dhe “punimet shkencore”



Shkruan: Besa
Ismaili-AHMETI,
*profesoreshë dhe
ish-deputete e Kuvendit të
Kosovës*

Është e ditur që një pjesë e caktuar e atyre që sot quhen “studime shkencore” nga shqiptarët në Perëndim nuk janë as shkencë, as kërkim serioz, por janë punime me copy-paste nga manualët e orientalizmit. Me vite kam pasur problem me këto “hipoteza” që s’i merrja dot seriozisht, sepse nuk vinin nga kërkimi, por nga inferioriteti personal dhe nga ambicia për të bërë karrierë shpejt, lehtë. (Ka populizëm edhe në të kërkuarit shkencor, jo vetëm në politikë) Në vend se të ishin zëra që mbrojnë historinë dhe pluralizmin e popullit shqiptar, ata u kthyen kundër popullit të vet. E kuptoj individualizmin akademik, por kur individualizmi kthehet në egoizëm të shëmtuar, rezultati është i qartë: prodhon “studime” që shajnë Islamin, shajnë lirinë dhe çlirimin dhe e paraqesin fenë islame ndër shqiptarë si problem, dhe jo si

vlerë. Kështu na patën dalë “studies” që përbaltin luftën çlirimtare të UÇK-së, duke e quajtur “luftë katundarësh” që vrasin njerëz intelektualë dhe të qytetit; dhe që flisnin për çlirimtarët si për “cubë grabitqarë” që kanë zbritur në qytete dhe po ua marrin oksigjenin njerëzve ‘normalë’; studiues/studiuese që i quanin hoxhallarët tradicionalë “ajatollahë shtypës”, që mercenarizonin çlirimin nga Serbia dhe praktikat fetare si ‘po i paguan Serbia me qenë myslimanë’; që flisnin për lloj-lloj rreziqesh që na vinin nga feja, nga ndryshimi i elitave, e çka jo tjetër.... Dhe si qershia mbi tortën e këtyre ‘studimeve’ ishin disa “feministe” që lavdërojnë Kanunin dhe burrneshat, që flisnin për patriotizmin e traditën shqiptare dhe shanin lirinë e zgjedhjes që kishin bërë gratë që bartnin shami. Feministe që shihnin komunizmin si emancipim, dhe fenë/besimin si patriarkalizim. Në vend të shekujve të bashkëjetesës, tolerancës dhe sekularizmit shqiptar, ata na servirnin ‘katundarin’, “gruan e shtypur”, “shaminë si pengesë”,

“Islamin si problem për Evropën”, etj. Nuk duhet harruar rastin e ISIS-it, kur disa djem nga Kosova u bënë pjesë e një fenomeni të ligë global, dhe kur “akademikët” menjëherë patën lansuar thirrje si “ndaloni fenë” dhe “mbyllni xhamitë!”, sikur për këtë gjë feja të ishte fajtorë. Studiues të dobët e oportunistë nuk humbën rastin, dhe ata e kthyen klimën e frikës në artikuj të gatshëm për disa revista të Perëndimit, duke e lidhur rritjen e ekstremizmit e dhunshëm me liritë fetare etj. Rezultati? Një imazh i rremë dhe i turpshëm për shqiptarët e Kosovës, të paraqitur si “më pak evropianë”, si rrezik dhe si pengesë për modernitetin. Dhe e keqja më e madhe? Nuk janë vetëm orientalistët e huaj fajtorë për imazhin e shqiptarëve në akademi, por edhe ata shqiptarë që pranuan të bëhen vegla të këtij rrethi islamofob dhe albanofob, duke shitur të vërtetën për pak famë akademike. Si përfundim, Kosova, me shekuj pluralizëm, me identitet të fortë kombëtar, fetar, shumëfetar dhe shumëkulturor dhe me kontribute moderne janë realitete që nuk i ndotë dot asnjë “studim”.

SHQIPTARËT MES POLITIKËS DHE ZHVILLIMIT



Shkruan: Nazmi JUSUFI

Historia e shqiptarëve ka qenë gjithmonë e lidhur ngushtë me politikën, shpeshherë si sfidë për mbijetesë kombëtare dhe shtetërore. Megjithatë, në periudhën e pasluftës dhe pas pavarësisë, sidomos në Kosovë, Shqipëri dhe trojet e tjera shqiptare, politika nuk ka arritur të shndërrohet në motor zhvillimi ekonomik e shoqëror. Përkundrazi, shpesh është bërë pengesë e modernizimit. Në vend që të prodhojë strategji për zhvillim të qëndrueshëm, politika jonë ka mbetur e kapur në ciklin e interesave afatshkurtra, të polarizimit partiak dhe të retorikës boshe. Kjo ka bërë që shumë potenciale njerëzore, financiare dhe intelektuale të mos shfrytëzohen si duhet. Të rinjtë shqiptarë, në mungesë të perspektivës, vazhdojnë të migrojnë masivisht drejt Perëndimit, duke e varfëruar kapitalin njerëzor në vend. Nga ana ekonomike, rajoni ku jetojnë shqiptarët ka pasuri

natyrore, pozitë gjeografike të favorshme dhe diasporë të fuqishme financiare. Por mungesa e stabilitetit politik, korrupsioni i lartë dhe sistemi i dobët institucional kanë penguar tërheqjen e investimeve serioze dhe ndërtimin e një tregu të brendshëm konkurrues. Pa institucione funksionale dhe pa sundim të ligjit, asnjë ekonomi nuk mund të lulëzojë. Në të njëjtën kohë, partitë politike në hapësirën shqiptare shpesh janë fokusuar tek betejat për pushtet dhe jo tek vizioni zhvillimor. Për shembull, energjia e shpenzuar në grindje politike do të duhej të orientohej në projekte konkrete: modernizimin e infrastrukturës, fuqizimin e arsimit dhe shëndetësisë, zhvillimin e industrisë prodhuese dhe nxitjen e inovacionit. Këto janë sektorët që krijojnë vende pune dhe gjenerojnë mirëqenie, por fatkeqësisht kanë mbetur në plan të dytë. Për të dalë nga ky rreth vicioz, shqiptarët kanë nevojë për një

politikë të re, që e sheh shtetin si instrument zhvillimi dhe jo si plaçkë pushteti. Politika e së ardhmes duhet të orientohet në tri shtylla kryesore: forcimin e institucioneve dhe sundimit të ligjit; investimin në kapitalin njerëzor përmes arsimit cilësor; dhe ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme e konkurruese në rajon dhe Evropë. Nëse politika shqiptare nuk reformohet, vendet tona do të vazhdojnë të mbeten konsumues të importit dhe eksportues të fuqisë punëtore. Por nëse politika guxon të bëhet vizionare, atëherë shqiptarët mund të shndërrojnë sfidat e sotme në mundësi për nesër. Sot shqiptarët nuk kanë më luksin të humbasin kohë me grindje sterile politike. Çdo ditë e humbur në fjalë është një hap prapa në zhvillim. Prandaj zgjedhja është e qartë: ose politika do të bëhet motor i zhvillimit, ose shqiptarët do të mbeten peng i saj. Koha është tani - dhe përgjegjësia është mbi ata që pretendojnë të udhëheqin.

VRESHTARËT ANKOHEN PËR ÇMIMIN E RRUSHIT, PARALAJMËROJNË PROTESTA

Prishtinë, 31 gusht - Në rajonin e Rahovecit po vazhdon fushata e vjeljes së rrushit. Vreshtarët ankohen se përpunuesit pak po e paguajnë rrushin. Kërkojnë rritje të çmimit për 10 centë për kilogramë, e nëse kjo nuk ndodh, thonë se nuk do ta dorëzojnë rrushin në bodrume. E këta të fundit paralajmërojnë rritje të çmimit të rrushit.

Pamje piktoreske kanë këtë vit vreshtat e qytetit të rrushit - Rahovecit. Hardhitë kanë sasi të konsiderueshme dhe mjaft cilësore të rrushit përkundër kushteve klimatike jo dhe aq të favorshme.

Hadi Behluli, 62 vjeç, i cili ka rreth 2.5 hektarë me rrush, thotë për Radio Kosovën se është i pakënaqur me çmimin me të cilin po blihet rrushi nga bodrumet. E kjo e ka shtyrë të dalë edhe në rrugë për të shitur. “Nuk jam i kënaqur me çmimin, se çmimi si ka qenë vitin e kaluar ka mbetur njëjtë, ani pse krejt çmimet po rriten. Edhe rrush nuk ka sivjet shumë, se e ka dëmtuar ngrica. Vjet çmimi i rrushit ‘smederevk’ që e kam unë ka qenë 25 centë, ndërsa i ‘pinotit të zi’ ka qenë 32 centë. Këto çmime janë edhe sivjet”, tha ai.

Një nga vreshtarët rahovecian është edhe Habib Dina, që ka 10 hektarë vreshta, e që ankohet për çmimin e rrushit. Ai thotë se çmimi nuk është rritur prej disa vjetësh, ndonëse gjithçka vit pas viti është shtrenjtuar. “Vitin e kaluar çmimi ka qenë prej 20 deri në 40 centë, e një mesatare ka qenë prej 28 centësh për kilogram - një çmim shumë i ulët krahasuar me kostot që ka prodhimi i rrushit që është një kulturë që kërkon angazhim dhe punë. Besoj se shumë vreshtarë këtë vit do të heqin dorë prej rrushit për përpunim, sepse është bërë e tepërt shkelja që po na bëhet nga përpunuesit e rrushit. Janë zhgënjyer. Çmimi i rrushit 25-30 centë nuk është çmim”, tha ai.

Dina thotë se në Shoqatën e Vreshtarëve kanë vendosur që të mos dorëzojnë rrushin në bodrume nëse nuk rritet çmimi për 10 centë për kilogram. Ai paralajmëron se mund të ketë edhe protesta.

Fidan Haxhijaha nga veraria “Bodrumi i Vjetër”, ku një pjesë e madhe e vreshtarëve e dorëzojnë rrushin, thotë se nuk ka paralajmërime nga fermerët se nuk do ta dorëzojnë rrushin. Ai thotë për Radio Kosovën se



do të ketë rritje të çmimit të blerjes së rrushit. “Ne luftojmë çdoherë për çmim që të ngrihet, sepse brenga e vreshtarëve është edhe brenga jonë, sepse është bashkëpunimi dhe interesi i përbashkët. Duke marrë parasysh inflacionin dhe vështirësitë që i kanë në shpenzime fermerët, vitin e kaluar kemi ngritur deri në 30 % të çmimit të rrushit. Edhe këtë vit do të ketë ngritje të çmimit,

mirëpo ngritja e çmimit vitin e kaluar ka reflektuar me pengesa në eksporte”, tha ai. Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, thotë se nuk mund të ndërhyjnë në përcaktimin e çmimit, ndonëse do që bujqit të shpaguhet. “E kuptoj papajtueshmërinë për çmimin. Mendoj se vreshtarët e verëtarët duhet të ulen bashkërisht dhe, ndoshta, nuk ka arsye të protestohet.

Mendoj se edhe verëtarët duhet të diskutojnë se a është ky çmimi që ata e kanë me interes që ta mbajnë apo duhet ta rritin çmimin për çdo varietet të rrushit. Zgjidhjen mund të gjejnë duke bashkëpunuar”, tha Latifi. Rahoveci tradicionalisht merret me kultivimin e rrushit dhe në këtë komunë llogaritet të jenë të mbjella mbi 3 000 hektarë rrush.

‘ALARMANTE’, SHUHEN RRETH 700 BIZNESE. JA FAKTORËT QË ÇUAN DREJT FALIMENTIMIT

PRISHTINË, 31 GUSHT - Rreth 700 biznese janë mbyllur në gjashtëmujorin e parë të këtij viti në Kosovë. Rritja e importit, shtrenjtimi i energjisë elektrike, mungesa e fuqisë punëtore, konkurrenca jo e drejtë dhe mungesa e një ligji për mbrojtjen e bizneseve, konsiderohen disa nga faktorët që ndikuan në mbylljen e qindra bizneseve. Ndonëse ka edhe një numër të bizneseve të reja të regjistruara në këtë periudhë, vlerësohet se kjo shifër e shuarjes duhet të jetë sinjal alarmues për qeverinë dhe institucionet e vendit.

Me falimentimin e bizneseve konsiderohet se po shuhen shumë vende të punës.

Drejtori ekzekutiv i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë,



Kushtrim Ahmeti, thotë për KosovaPress se në vend të mbylljes, Kosova ka nevojë për hapjen e bizneseve të reja dhe

fuqizimin e atyre ekzistuese, por përballja me sfida të shumta, siç potencon ai, po e vështirëson këtë proces.

Ahmeti thekson se kostoja e lartë e punës, inflacioni, varësia nga importi dhe rritja e çmimit të rrymës janë ndër faktorët kryesorë që po rrezikojnë qëndrueshmërinë e bizneseve. Ai shtoi se konkurrenca e ashpër nga produktet e importuara, rritja e çmimeve dhe mungesa e një ligji që mbron bizneset vendore, po e bëjnë të vështirë mbijetesën e tyre. Një tjetër problem serioz, sipas Ahmetit, përveç mungesës së punëtorëve, është edhe largimi i atyre me përvojë, që po e dëmton rëndë tregun vendor.

Nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) thonë se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025 janë mbyllur 698 biznese, ndërkaq në periudhën e njëjtë të vitit të

kaluar numri i mbylljes së bizneseve ishte 833, ndonëse krahasuar me periudhën përkatëse të vitit të 2024, këtë vit ka një rënie të numrit të bizneseve që janë shuar. “Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025 janë shuar/mbyllur 698 biznese, përdërisa për të njëjtën periudhë kohore në vitin 2024 janë shuar/mbyllur 833 biznese. Për periudhën kohore janar-dhjetor 2024 janë shuar/mbyllur 1633 biznese”, thuhet në përgjigjen e MINT-it dërguar për KosovaPress. Eksperti i ekonomisë, Adem Qorrolli, thotë se mbyllja e bizneseve vitet e fundit nuk po ndodh vetëm te bizneset sezonale, siç ishte më parë por, sipas tij, po prek edhe ndërmarrjet e mëdha me shumë punëtorë.

Pas produkteve ushqimore, shtrenjtohen edhe produktet e drurit, tekstilit dhe metalit

PRISHTINË, 31 GUSHT - Çmimet e produkteve ushqimore, përfshirë edhe ato esenciale, kanë shënuar ngritje këtë vit. Qytetarët janë ankuar se krahasuar me standardin jetësor në vend, çmimet janë shumë të larta. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, çmimet e konsumit në korrik të këtij viti krahasuar me atë të vitit të kaluar janë prej 4.3 % më

të larta. Çmimi i vajrave dhe yndyrave është rritur për 9,9 %, i mishit për 12,7 %, i pemëve 12,3 %, i perimeve 10,7 %, ndërsa i kafesë dhe çajit për 16,9%.

Përveç ushqimeve, ngritje pati edhe të çmimet e produkteve të drurit, prodhimeve të tekstilit, atyre të gomës e plastikës si dhe produkteve të fabrikua metalike.

Njohës të ekonomisë thonë se ngritja e çmimit të energjisë elektrike ka ndikuar në ngritjen e çmimeve të produkteve të tjera.

Bellaqa tha se shqetësues është edhe fakti që Kosova varet më shumë nga importi.

Me daljen në tregun e lirë energjetik, bizneset e mëdha kanë paralajmëruar edhe më tej ngritje të çmimeve. (rtk)



PSE JE MË BUDALLA SE SA MENDON!

Dy libra mbi atë që dimë ose mendojmë se dimë sugjerojnë se historia e budallallëkut mund të jetë po aq e gjatë sa vetë historia e njerëzimit.

Nga: Christopher BRAY / *The Daily Telegraph*

Ndalu për një moment dhe mendo për fuqinë mendore të njerëzve të ndryshëm në jetën tënde – familjarë, miq, kolegë, zejtarë. Ndonjë mund të ketë mendje të ndritur që arrin të bëjë llogaritje me numra me tri shifra ose që gjithmonë mëson shpejt gjuhën kur shkon jashtë për pushime. Por, nuk do të gjeni, do të vë bast, ndonjë Einstein apo Chomsky. Po të jemi të sinqertë, shumica e njerëzve që njohim janë goxha mesatarë për nga kapaciteti mendor.

Tani mendoni për këtë: nëse kjo është e vërtetë, atëherë gjysma e popullsisë së botës bie nën atë mesatare. Për më tepër, nëse merremi me pjesën më të madhe të shekullit XX, mesatarja e IQ-së [koeficientit të inteligjencës] ka qenë në rënie gjatë tri dekadave të fundit. Dhe, tani, përpikuni ta përtypni këtë gjetje nga një studim i fundit: vetëm dy për qind e britanikëve besojnë se kanë inteligjencë më të ulët se mesatarja.

Por, siç vëren Stuart Jeffries në Një histori e shkurtër e budallallëkut [A Short History of Stupidity], “budallenjtë, si të varfrit, janë gjithmonë mes nesh”. Libri i ri i tij na bledh nga bota klasike deri në epokën digjitale. Ka marrëzi në Lindjen e Largët – në proverbën kineze për njeriun që i ra shpata në një lumë dhe u përpoq të shënonte vendin me një gërvishtje në varkën e tij – pastaj, në shekullin XX janë sjelljet patetike shfaqësuese të Adolf Eichmannit në gjyqin kundër tij në Jerusalem. Dëgjojmë për gjithçka, nga marrëzitë e romanit të madh të Flaubertit, Buvari dhe Pekushe [Bouvard et Pécuchet], deri te pretendimet e çuditshme të Francis Fukuyamas për “fundin e historisë.”

Jeffries mund të jetë, siç pranon vetë me sinqeritet, dikush që (fjalë për fjalë) nuk di si të ndërrojë një poç. Por, ai e di mirë dallimin mes teveqelëve dhe budallenjve dhe është i prirur t’i definojë termat. U gëzova kur mësova ndryshimet mes “idiotëve”, “imbecilëve” dhe “moronëve”. Jo sepse përkufizimet janë të sakta: sipas përkufizimit, zhvillimi mendor i një idioti nuk i kalon kurrë dy vjetët e një fëmije; një imbecil është afërsisht në nivelin e një fëmije shtatëvjeçar; dhe një moron ka inteligjencën e një fëmije dymbëdhjetëvjeçar. Por, sepse njeriu që shpiku atë taksonomi

të vjetruar ishte një psikolog i quajtur Edmund Burke Huey, një rast i determinimit nominativ – “berk” [budalla], “hooley” [teveqel] – tejkaluar vetëm nga zbulimi i Jeffries se psikologu që e përkufizoi inteligjencën si “aftësia për të kaluar mirë në një test inteligjence” quhej Edwin G. Boring [i mërzhitshëm].

Por, çfarë është vetë budallallëku? Këtu Jeffries është më pak i qartë: ai e përkufizon atë më shumë duke përkthyer çfarë nuk është. Për shembull, budallallëku nuk është injorancë – dakord, edhe pse edhe më i marri do ta kishte kuptuar këtë. As nuk është mungesë zgjuarsie, të cilën Jeffries e përshkruan si llojin e marrëzisë “vetëruajtëse, strategjikisht inteligjente” të cilën ai e sheh të mishëruar te Jade Goody nga Big Brother – një grua që monetizoi paditurinë e vet. As nuk është një lloj çmendurie, gjë që mund të jetë e padiskutueshme, edhe pse do të doja që Jeffries ta kishte argumentuar këtë. Ai, sidoqoftë, ka shumë simpati për [filozofin] Michel Foucault, një nga argumentet më të kuptueshme të të cilit ishte se çmenduria është një reagim i arsyeshëm ndaj një bote të çmendur.

Pasi lë abstraksionet mënjanë, Jeffries kalon te çështjet konkrete. Ne jetojmë, thotë ai, në një botë në të cilën “të çmendurit pas pushtetit dhe injorantët lulëzojnë”: një botë në të cilën një president i Shteteve të Bashkuara (një zotëri Trump) mund të inkurajojë publikisht këshilltarët shkencorë të humumtojnë nëse të sëmuret me koronavirus duhet t’ia injektojnë vetes zbardhuesin, dhe një kryeministër britanik (një zotëri Johnson) thuhet se “dallimin midis rrezikut absolut dhe atij relativ e ka ‘pothuajse të pamundur për ta kuptuar’”.

Ashtu si burrështetasi athinas Alkibiadi, para tyre, budallenjtë e tillë – dhe kushdo që bindet prej tyre – kanë nevojë për atë që Jeffries e quan “terapia intelektuale” e metodës sokratike. Nuk do të pushoni së qeni budallenj dhe do të filloni të fitoni çdo debat; përkundrazi, argumenton Jeffries, mësimi i Sokratit, i cili përmes nxjerrjes së pasojave të linjës suaj të argumentit mundëson mendim vërtet kritik, do t’ju lejojë të kuptoni kufizimet tuaja. Sepse, siç vazhdonte t’u kujtonte Sokrati njerëzve, njeriu i urtë është ai që e di se nuk është i urtë.

Pjesa më e madhe e të



qeshurave në Një histori e shkurtër e budallallëkut vjen nga sfera politike. Ishte e këndshme të përmendej sugjerimi i Sarah Palinit në vitin 2010 se “myslimanët paqësorë” duhet të “refudiate” [të “heqin dorë”] nga planet për të ndërtuar një xhami pranë Zonës Zero në Nju Jork. Ishte edhe më e këndshme të mësohej se më vonë ajo u përpoq të mbronte gabimin e saj duke pretenduar se ishte gabim shtypi. (Jeffries vëren “sa larg është ‘f’ nga ‘p’ në një tastierë QWERTY” dhe e quan pretendimin e saj “pāncipul” [fanciful/të habitshëm].) Sa për fjalimin e Donald Trumpit të vitit 2017 për Puerto Rikon, që ishte “një ishull i rrethuar nga ujë, ujë i madh, ujë oqeani”, as Groucho Marx në [filmin] Duck Soup nuk foli me një marrëzi të tillë poetike.

Megjithatë, ka diçka shqetësuese te përqendrimi i vazhdueshëm i autorit mbi figurat e së djathtës. Si munda t’i kalonte pa koment, për shembull, marrëzitë konspirative të David Graeberit të ndjerë – një komentues kryesor i së majtës – për pretendimin se ende presim një kurë për kancerin sepse klasa sunduese këmbëngul që studiuesit të derdhn gjithë energjitë e tyre te [ilaçet] Ritalin dhe Prozac, për të qetësuar më mirë secilin që mendon për revolucion? Siç tha Orwell, disa gjëra janë aq qesharake saqë mund të besohen vetëm nga një “intelektual i së majtës ... asnjë njeri i zakonshëm nuk mund të jetë një budalla i tillë”. Megjithatë, kjo është një vogëlsi. Një histori e shkurtër e budallallëkut është libër i zgjuar, didaktik dhe me informata të shumta. Dyshoj që

kushdo që kalon pak kohë me librin e Jeffriesit nuk do të ndihet më pak budalla se më parë.

E njëjta gjë nuk vlen për librin marramendës të Steven Pinkerit, Kur të gjithë dinë se të gjithë dinë ... [When Everyone Knows That Everyone Knows ...]. Pinkeri, profesor i psikologjisë në Harvard dhe autor i shumë bestsellerëve të shkencës popullore, e përshkruan këtë libër si një nga veprat e tij “popullore” (për dallim nga ato akademike), gjë që e bën edhe më zhgënjyes sepse është i mërzhitshëm nga fillimi deri në fund. Libri pretendon të jetë një analizë e logjikës dhe psikologjisë së dijes së përbashkët: “Si mendojnë njerëzit për atë që njerëzit e tjerë mendojnë, dhe si ata mendojnë për atë që njerëzit e tjerë mendojnë se ata mendojnë, dhe si ata mendojnë për atë që njerëzit e tjerë mendojnë se ata mendojnë se ata mendojnë”. Dhe, supozoj se, në këtë aspekt, Pinkeri gjithnjë sjell deklarata të asaj që [karakterit komik] Basil Fawlty e quajti “gjakderdhje e qartë” dhe tregon se sa e zakonshme mund të jetë “dija e përbashkët” – nga investimet e supozuara të sigurta te ideologjitë që premtojnë të shërojnë gjithçka.

Megjithatë, ai është kryesisht i mbushur me histori të kota: tri faqe për mënyrën se si njerëzit e ndryshëm përballen me faktin që u ngec spinaqi mes dhëmbëve në darkë! Dhe, nuk kalon shumë kohë para se faqet të bëhen të turbullta, e fjalitë e Pinkerit të duken gjithnjë e më shumë si nyja gordiane: “Sally e di që unë jam i vetëdijshëm që ajo e kupton që unë e kuptoj që ajo e njeh që unë e di që ajo është e vetëdijshme që unë e

kuptoj që ajo e kupton që unë e njoh që ajo e di që unë jam i vetëdijshëm që ajo e kupton që unë e njeh që unë e di që ajo e kupton që unë jam i vetëdijshëm për aksidentin e makinës”.

Nuk është gjithçka keq. Ka një seksion të këndshëm mbi atë që mund ta quajmë semiotika e skuqjes – “një falje joverbale, më e besueshme se fjala e lirë, sepse vjen nga sistemi nervor autonom i pavullnetshëm” – që do t’ju bëjë të mendoni për mënyrat e ndryshme se si njerëzit komunikojnë pa dashur. Dhe, diskutimi i Pinkerit mbi të nënkuptuarën është vërtet informues. Por, nuk ka dyshim se gjithçka është kaq e mërzhitshme dhe serioze – mendoni për Pinkerin si [folësi] Malcolm Gladwell me steroide – aq sa ju bën të dëshironi të hidhni librin tutje dhe të fusni filmin Carry On në DVD.

Pinker kalon disa faqe ku, për shembull, shqyrton shtresat e dijes, të përbashkët ose jo, që dramatizohen – dhe nënkuptohen në leximet tona – nga Petkat e reja të Perandorit. Tani, përralla e Hans Christian Andersenit duhet të jetë e njohur për këdo që ka mbushur gjashtë vjet; megjithatë, Pinkeri e stolis analizën e tij me jo më pak se pesë ilustrime të mënyrave të ndryshme se si njerëzit kapin domethënien e tregimit dhe se si të tjerët mundën ose nuk mundën ta kuptojnë atë nga ana e tyre. Derisa ai kalon te një enigmë për dy burra që përpiqeshin të nxirrnin ditëlindjen e një vajze që sapo kishin njohur – një histori e plotësuar me tabela dhe grafika – unë isha i hutuar. Ftesë për z. Stuart Jeffries: Një histori e shkurtër e budallallëkut ka nevojë për një kapitull tjetër. /Telegrafi/

PLANI ‘AMERIKAN’ PËR TA KTHYER GAZËN NË RIVIERËN E LINDJES SË MESME

Një plan 38-faqësh për Rripin e Gazës pas luftës, i titulluar “Nga një protektorat iranian i rrënuar në një aleat të begatë”, po qarkullon në administratën e Presidentit të SHBA-së, Donald Trump.

Plani i hartuar nga organizata kontroverze Fondacioni Humanitar i Gazës (GHF), e cila mbështetet nga SHBA-të dhe Izraeli, parashikon administrimin e enklavës palestineze të shkatërruar nga lufta prej Amerikës për të paktën një dekadë, zhvendosjen e përkohshme të popullsisë së Gazës dhe rindërtimin e enklavës bregdetare palestineze, për ta kthyer në një vendpushim turistik dhe qendër industriale. Plani është zbuluar nga media amerikane Washington Post, që thotë se popullsia e Rripit të Gazës prej 2 milionë banorësh do të largohet ose përmes largimeve “vullnetare” në një vend tjetër ose në zona me akses të kufizuar brenda enklavës palestineze gjatë rindërtimit.

Reuters ka raportuar më parë se ekziston një propozim për të ndërtuar kampe në shkallë të gjerë të quajtura “zona

humanitare tranziti” brenda dhe ndoshta jashtë Rripit të Gazës për të strehuar popullsinë palestineze. Fondacioni Humanitar i Gazës (GHF), e cila filloi shpërndarjen e ndihmave në maj është një organizatë e dyshimtë e mbështetur nga SHBA-të dhe Izraeli, e cila qëndron pas planit.

Sipas planit pronarëve të tokës do t’u ofrohet një “kupon digjital” në këmbim të të drejtave për të rindërtuar pronën e tyre, raportoi Post. Përveç kësaj, çdo palestinezi që largohet do t’i jepen 5,000 dollarë cash dhe një subvencion për të mbuluar qiranë për katër vjet. Ata gjithashtu do të marrin ushqim për një vit.

Plani, i quajtur “Trusti i Rindërtimit, Përsheptimit Ekonomik dhe Transformimit të Gazës, ose Trusti i MADH”, u zhvillua nga GHF, raporton Post. Pranë titullit të tij, plani përfshin sloganin e mëposhtëm: “Nga një protektorat iranian i rrënuar në një aleat të begatë abrahamik”. Shtëpia e Bardhë dhe Departamenti i Shtetit nuk iu përgjigjën menjëherë një



kërkese për koment, por plani për rindërtimin e Gazës duket se është në përputhje me deklaratat e mëparshme të Trump.

Më 4 shkurt, presidenti amerikan tha publikisht për herë të parë se SHBA-të duhet të “marrin në dorë” Rripin e Gazës të shkatërruar dhe të

uritur dhe ta shndërrojnë atë në rivierën e Lindjes së Mesme, pasi të zhvendosin popullsinë palestineze diku tjetër. Deklarata e Trump zemëroi shumë palestinezë dhe grupe humanitare në lidhje me zhvendosjen e mundshme me forcë nga Gaza.

Sakaq, forcat izraelite sulmuan

periferitë e qytetit të Gazës gjatë natës së shtunës dhe të dielës nga ajri dhe toka, duke shkatërruar shtëpi dhe duke dëbuar më shumë familje nga zona, ndërsa kabineti i sigurisë i kryeministrit Benjamin Netanyahu u mblodh sot për të diskutuar një plan për të pushtuar qytetin.

LINDSHMËRIA BIE ME SHPEJTËSI — MUSK PARALAJMËRON: “EUROPA PO SHUHET”



Sipërmarrësi dhe miliarder amerikan Elon Musk shprehu shqetësim të thellë për të ardhmen demografike të kontinentit evropian, duke reaguar ndaj të dhënave të frikshme nga Skocia: në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, numri i vdekjeve tejkaloj lindjet me 34 % .

Ai shkroi në llogarinë e tij: “Nëse norma e lindjeve nuk rikthehet të paktën në nivelin e zëvendësimit, Europa do të shuhet.”

Sipas ekspertëve, për të ruajtur qëndrueshëm popullsinë, çdo grua duhet të lindë të paktën 2.1 fëmijë. Disa shkencëtarë argumentojnë se për një

mbijetesë afatgjatë, kjo shifër duhet të jetë edhe më e lartë — deri në rreth 2.7 fëmijë për grua . Situata është edhe më alarmante në Europë: norma e lindshmërisë në vendet e Bashkimit Evropian dhe në Angli ka zbritur në 1.4, ndërsa në Skoci është vetëm 1.3 fëmijë për grua — niveli më i ulët

historik . Si një njeri me të paktën 14 fëmijë, Musk ka bërë donacione të konsiderueshme për kërkime në fushën e demografisë dhe e sheh krizën riprodhuese si një kërcënim më të madh për civilizimin sesa ndryshimet klimatike . Sipas të dhënave të

Organizatës së Kombeve të Bashkuara, prirja globale për ulje të lindshmërisë po vazhdon prej dekadash. Mesatarja botërore e lindshmërisë në vitin 2024 ishte rreth 2.2 fëmijë për grua — shumë më pak se në vitet 1970 (5 fëmijë) dhe 1990 (3.3 fëmijë).



Zhegrova, lojtari më i ri i Juventusit

TORINO, 31 GUSHT - Eksperti i transferimeve, Fabrizio Romano e ka dhënë “Here we go”-në e famshme për Edon Zhegrovën te Juventusit. Romano ka raportuar se tashmë ylli kosovar do të jetë lojtari më i ri i Juventusit, pasi

Lille e pranoi ofertën e “Zonjës së Vjetër”. Juventusit do të paguajë një pako prej 20 milionë eurosh për Zhegrovën, me këtë të fundit që tash e disa ditë e ka pranuar ofertën e klubit bardhezi nga Turini. Fabrizio ka shtuar më tej, që

nëse gjithçka shkon sipas planit, Zhegrova sonte do të udhëtojë për në Turin. Zhegrova është pjesë e Lille që nga janari i vitit 2022. Sezonin e kaluar, ylli dardan shënoi tetë gola në pjesën e parë të sezonit, teksa në pjesën e dytë

nuk u paraqit fare shkak u një lëndimi. 26-vjeçari është pjesë e listës së Kosovës për ndeshjet e shtatorit, ndaj Zvicrës e Suedisë, ndeshje që luhen në kuadër të kualifikimeve për kampionatin botëror të vitit 2026.



GJILANI, DRENICA E BALLKANI REALIZOJNË FITORET E PARA, DUKAGJINI VAZHDON ME FORMË TË MIRË

GJILAN, 31 GUSHT - Gjilani arriti fitoren e parë këtë edicion në AlbiMall Superligë, duke e mposhtur Prishtinën, në derbin e javës së tretë, të zhvilluar në fushën me bari sintetik në Gjilan, me rezultat 3:1. Skuadra e trajnerit Ardian Nuhui e nisi furishëm ndeshjen, duke shënuar dy gola të hershëm me anë të Edi Bashës (4') dhe Senad Jarović nga penalltia (11'). Në pjesën e dytë, Prishtina ngushtoi epërsinë me golin e Blend Baftiut (65'), por kapiteni Armend Thaqi (91') vulosi fitoren e merituar të



gjilanasve. Pas kësaj fitoreje, Gjilani ka katër pikë nga tri ndeshje, ndërsa Prishtina mbetet në kuotën e gjashtë pikëve. Drenica gjithashtu shënoi fitoren e parë pas

rikthimit në elitë, duke e mposhtur Prishtinën e Re, në stadiumin “Bajram Aliu”, me rezultat minimal 1:0. Golin vendimtar e realizoi Kreshnik Uka, në minutën e 77-të. Për

Prishtinën e Re kjo ishte humbja e dytë rresht, pas asaj ndaj Ferizajt në javën e kaluar. Dukagjini e vazhdoi me formë të mirë, duke marrë fitoren e dytë rresht. Klubi nga Klina triumfoi si mysafir ndaj Malishevës, në stadiumin “Liman Gegaj”, me rezultat 1:0, falë golit të shënuar nga Altin Merlaku (63'). Malisheva mbetet pa fitore në këtë edicion, me dy barazime dhe një humbje. Ndërkohë, Ballkani, pas dy barazimeve, regjistroi fitoren e parë këtë edicion duke e mposhtur Ferizajn, në udhëtim me

rezultat 3:1. Marsel Ismajlgeci (13') kaloi suharekasit në epërsi, ndërsa Kastriot Selmani (35') barazoi për vendasit. Megjithatë, në minutat shtesë, Ballkani tregoi forcën duke shënuar dy gola të shpejtë me anë të Valentin Serebes (90') dhe (90'+7'). Pas javës së tretë, Prishtina, Dukagjini dhe Ferizaj kryesojnë me nga gjashtë pikë, ndërsa Ballkani tani renditet i katërti me pesë pikë. Ndeshja përmbyllëse e javës së 3-të zhvillohet nesër në stadiumin “Zahir Pajaziti” në Podujevë, ndërmjet Llapit dhe Dritës.

PIASTI TRIUMFON NË HOLANDË

AMSTERDAM, 31 GUSHT - Australasi Oscar Piastru ka fituar Çmimin e Madh të Holandës në Formula 1, duke përfutur nga tërheqja e shokut të skuadrës dhe rivalit kryesor, Lando Norris. Me këtë sukses, Piastru ka zgjeruar epërsinë në renditjen e përgjithshme në 35 pikë. Me nëntë gara të mbetura, piloti i McLarenit grumbulloi plot 35 pikë, ndërsa Norris, që u

detyrua të tërhiqej, do të ketë mundësinë të reagojë javën e ardhshme në pistën legjendare të Monzës për Çmimin e Madh të Italisë. Gara nisi me tension: Verstappen e kaloi Norrisin me një manovër të rrezikshme që gati e nxori jashtë pistës, por në xhiron e nëntë Norris riktheu vendin e dytë. Shiu i lehtë shtoi dramë në pistë, ndërsa në xhiron e 23-të Hamilton u

përplas me murin në momentin kur po synonte të hynte në bokse, duke shkaktuar daljen e makinës së sigurisë dhe zhdukjen e avantazhit të Piastrit. Më vonë, Leclerc kaloi Russell për të marrë vendin e pestë, por në xhiron e 52-të pësoi të njëjtin fat si Hamilton, duke dalë nga pista dhe përfunduar garën. Edhe Ferrari tjetër nuk e përfundoi garën.



Në xhiron e 65-të, Norris u detyrua të tërhiqej për shkak të një defekti në motor, ndërsa makina e sigurisë u rikthye në

pistë. Nuk pati më ndryshime në renditje, dhe Piastru e mbylli garën i pari, përpara Verstappen dhe Hadjar – i cili përjetoi podiumin e tij të parë në karrierë. Pas kësaj gare, Piastru kryeson me 310 pikë, i ndjekur nga Norris me 275. Verstappen është i treti me 205 pikë, më pas Russell me 189, Leclerc me 151 dhe Hamilton me 109 pikë.

DERBI I TAKON LIVERPOOLIT



LIVERPOOL, 31 GUSHT - Liverpools dhe Arsenali u përballen në xhiron e tretë të Ligës Premier, ku “Reds” arritën të merrnin fitoren me rezultat 1-0 pas një ndeshjeje të fortë, por me pak raste shënimi. Në minutën e 36-të, Arsenal kishte një mundësi të shkëlqyer me Noni Madueke, i cili gjeti hapësirë brenda zonës

dhe gjuajti drejt portës, por gjuajtja e tij u bllokua në mënyrë fantastike nga mbrojtësi. Liverpools reagoi në pjesën e dytë. Në minutën e 61-të, Florian Wirtz u gjend në hapësirë brenda zonës, por goditja e tij e ulët u ndal nga portieri David Raya, duke mbajtur rezultatit të paprekur, por Hugo Ekitike

shënoi nga afër. Ky gol i Liverpool u anulua për pozicion jashtë loje. Goli vendimtar erdhi në minutën e 83-të, kur Dominik Szoboszlai tregoi saktësinë e tij nga goditjet e lira, duke dërguar topin në rrjet nga distanca dhe duke e bërë portierin Raya të pafuqishëm në reagim. Në minutën e 86-të, Eberechi Eze u

rrëzua brenda zonës pas një sfidimi nga mbrojtësi i Liverpools, por gjyqtari vendosi të lejojë lojën të vazhdojë, duke mos dhënë penallti. Me këtë fitore, Liverpools ngjitet në kuotën e 9 pikëve pas tre xhirore, ndërsa Arsenal pëson humbjen e parë të sezonit dhe mbetet me 6 pikë.

Ramadani mungon në ndeshjet e shtatorit

Tiranë, 31 gusht - Mesfushori i kombëtares shqiptare, Ylber Ramadani, nuk do të jetë i gatshëm për dy ndeshjet e muajit shtator. Ai do të mungojë në miqësoren ndaj Gjibraltarit më 4

shtator dhe në sfidën kualifikuese të Botërorit 2026 kundër Letonisë në “Air Albania”. Lajmi është konfirmuar nga Departamenti i Komunikimit në FSHF, i cili bëri të ditur se

futbollisti vuan nga një infeksion i përsëritur i laringut. Sipas federatës, gjendja e tij kërkon disa ditë pushim dhe terapi me antibiotikë, duke e pamundësuar grumbullimin me Kombëtaren.

Mungesa e Ramadani është një goditje për trajnerin Sylvinho, pasi mesfushori ka qenë një nga lojtarët më të rëndësishëm në skemën e tij gjatë ndeshjeve të fundit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare, lidhur me nenin 29.3 Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.1470 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS
për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita: Auditor junior për auditim të performancës
Numri i referencës: AJAP/ZKA/10-09/25
Grada: ZKA-Z4
Numri i pozitave: Nje (1)
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen auditime sipas planit vjetor, rregullave dhe metodologjisë së ZKA-së, Kodit të Etikës dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe raporton Drejtorit të Departamentit të Auditimit dhe udhëheqësit të ekipit të auditimit;
- Kryen hulumtime dhe analizë për fushën të caktuar dhe bën propozimin e temave audituese për planifikimin strategjik dhe atë vjetor të ZKA-së;(nën mbikëqyrje nga UA);
- Pjesëmarrje aktive në parastudim të auditimit në fusha të caktuara dhe deleguara nga UE;
- Ofron përkrahje profesionale duke kryer hulumtime dhe analiza të të dhënave të mbledhura dhe prezantimin e tyre;
- Mbajtja e shënimeve dhe dokumentimi i intervistimit dhe gjetjeve tjera;
- Nxjerrja konkluzioneve dhe dhënia e rekomandimeve duke u mbështetur në dëshmitë audituese dhe në bazë të gjykimit profesional;
- Përgatitja e Letrave të punës me kohë së bashku me dëshmitë përkatëse dhe memo përmbledhës lidhur me auditimin e komponentës, fushës apo pyetjeve audituese, e cila i është caktuar;
- Indeksimi i letrave të punës dhe diskutimi me Udhëheqësin e tij/saj;
- Raportimi i vazhdueshëm të mbikëqyrësi lidhur me progresin e arritur në auditim;
- Aplikimi i punës online sipas kërkesave dhe udhëzimeve në nivel të zyrës për situata të caktuara;
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale të kërkuara nga UEA dhe nga Drejtori i departamentit.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet e performancës janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridik, administratë publike, shkenca politike, shëndetësi, komunikimit ose inxhinierisë;
- Përvoja profesionale: Dy (2) vite përvojë pune profesionale në hulumtim, analiza, financa ose auditim;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri në fushën e auditimeve;
- Shkathtësi në organizim të punës dhe përmbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomati e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetimi i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **16.09.2025 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U prilog članu 15.2 Zakona Br. 05/L-055 za Generalnog Revizora i Nacionalnu Kancelariju Revizije Republike Kosovo, kao i članova 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 01/2024 o Prijemu i Karijeri u Nacionalnoj Kancelariji Revizije u vezi sa čl. 29.3 Uredbe (NKR) 03/2024 o Klasifikaciji Radnih Mesta; Godišnjeg Plana Zapošljavanja za 2025. godinu kao i Odluku Generalne Revizorke pod Nr. 1470 za popunjavanje upražnjenog radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS
za popunu slobodnog radnog mesta

1. Pozicija: Junior Revizor za reviziju učinka
Referentni broj: AJAP/NKR/10-09/25
Rang: NKR-Z4
Broj pozicija: Jedan (1)
Trajanje imenovanja: Neograničeno

Dužnosti i odgovornosti:

- Vrši revizije u skladu sa godišnjim planom, pravilima i metodologijom NKR, Etičkim kodeksom i u skladu sa Međunarodnim standardima revizije i izveštava Direktora Sektora za reviziju i vođu revizorskog tima;
- Vrši istraživanje i analizu za zadata oblast i predlaže teme revizije za strateško i godišnje planiranje NKR (pod nadzorom VR);
- Aktivno učešće u pred-studijama revizije u određenim oblastima delegirane od strane VT;
- Pruža stručnu podršku kroz istraživanje i analizu prikupljenih podataka i njihovu prezentaciju;
- Vođenje beleški i dokumentovanje intervjuja i drugih nalaza;
- Donošenje zaključaka i davanje preporuka na osnovu revizorskih dokaza i na osnovu profesionalnog prosuđivanja;
- Blagovremena priprema Radnih papira zajedno sa relevantnim dokazima i rezimeom memoranduma koji se odnosi na reviziju komponente, oblasti ili pitanja revizije koja su mu dodeljena;
- Indeksiranje radnih papira i razgovor sa njegovim/njenim menadžerom;
- Kontinuirano izveštavanje nadzornika o napretku postignutom u reviziji;
- Primenjivanje onlajn rada prema zahtevima i uputstvima na nivou kancelarije za određene situacije;
- Obavlja i druge profesionalne poslove koje zahteva VT i Direktor Odeljenja.

Opšti formalni uslovi za ovo radno mesto, u reviziji učinka, su:

- Obrazovanje: Diploma fakulteta ekonomije, prava, javne administracije, političkih nauka, zdravstva, komunikacija ili inženjeringa.
- Profesionalno iskustvo: Dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva u istraživanju, analizi, finansijama i reviziji;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

Potrebne veštine:

- Istaknuto znanje iz oblasti revizije;
- Veština u organizovanju rada i ispunjavanju ciljeva;
- Poznavanje pravnih akata koji se primenjuju u Nacionalnoj Kancelariji Revizije;
- Poznavanje efektivnog nadzora nad stručnim radom;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Motivacione i komunikacione veštine u timu;
- Poseduje dobre međuljudske veštine.

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Postupak prijave:

Postupak prijave je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i kandidatima iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti potrebnu dokumentaciju, i to:

- službeni obrazac NKR za prijavu;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (Fakultetska diploma). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- potvrda iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa javne funkcije (ako se primenjuje);

U obzir će se uzeti samo zvanični obrazac za prijavu. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće se razmatrati, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (online) i na internetskoj stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za predaju dokumentacije je dana **16.09.2025 u 16.00 časova**.

Obrasci za prijavu mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa web stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i predati Odeljenju za administraciju dokumenata na adresi: Naselje: Arberia, ul. "Ahmet Krasnići" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 časova, obrazac i prateća dokumentacija se mogu dostaviti i putem imejla na adresu rekrutimi@oagks.org ili putem pošte. Za detaljnije informacije možete nas kontaktirati na tel. 038/606-004, lokal 1025.

Napomena:



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U prilog članu 15.2 Zakona Br. 05/L-055 za Generalnog Revizora i Nacionalnu Kancelariju Revizije Republike Kosovo, kao i članova 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 01/2024 o Prijemu i Karijeri u Nacionalnoj Kancelariji Revizije u vezi sa čl. 26 Uredbe (NKR) 03/2024 o Klasifikaciji Radnih Mesta; Godišnjeg Plana Zapošljavanja za 2025. godinu kao i Odluku Generalnog revizora pod br. 1470 za popunjavanje upražnjenog radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS
za popunu slobodnog radnog mesta

1. Pozicija:

Referentni broj:

Rang:

Broj pozicija:

Trajanje imenovanja:

Analitičar za planiranje i izveštavanje

APR/ZKA/11-09/25

ZKA-Z3

Jedna (1)

Neodređeno

Dužnosti i odgovornosti:

- Pod direktnim uputstvima direktora, sprovodi analize Zakona o izdvajanju budžetskih sredstava i analize drugih podataka, i dostavlja iste revizorskim timovima i timu za reviziju Godišnjeg revizorskog izveštaja;
- Prikuplja potrebne podatke za revizorske timove, sa posebnim akcentom na periodične izveštaje o budžetu, prihodima, rashodima i druge izveštaje, i vrši analizu i selekciju podataka prema potrebama revizije ; dostavlja iste direktoru sa sažetkom za potrebe menadžmenta ;
- U koordinaciji sa glavnim odgovornim za izradu GIR, pomaže revizorskom timu u izradi raznih analiza;
- Obavlja i druge zadatke koje mu dodeli nadređeni iz relevantne oblasti;
- Redovno izveštava o rezultatima i uticaju rada.

Opšti formalni zahtevi za ovo radno mesto:

- Obrazovanje: Univerzitetska diploma ekonomije, prava ili javne administracije
- Profesionalno iskustvo: Sedam (7) godina stručnog radnog iskustva u analizi, planiranju i izveštavanju u oblasti ekonomije i finansija.
- Poželjno je znanje engleskog jezika.

Potrebne veštine:

- Napredno znanje u oblasti analize, planiranja i izveštavanja;
- Veštine konsultovanja i vođenja analitičkih evidencija;
- Poznavanje pravnih akata koji se primenjuju u Nacionalnu kancelariju revizije;
- Efikasno stručno radno znanje;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Motivacione i komunikacijske sposobnosti u timu;
- Poseduje dobre međuljudske veštine.

Opšte informacije za kandidate:
Određivanje plate se vrši u skladu sa važećim zakonskim propisima .

Postupak prijave:
Postupak prijavljivanja je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna kancelarija revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i poziva kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati moraju da dostave potrebnu dokumentaciju, i to:

- službeni obrazac za prijavu NKR;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o obrazovnoj spremi (diploma fakulteta). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu, uz dokaz iz Fondacije);
- dokaz iz suda da nije osuđen pravosnažnom odlukom (ne stariji od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za otpuštanje sa položaja javnog službenika (*ako je primenljivo*);

Samo službeni obrazac za prijavu će biti uzet u obzir. Dokumenti podneti nakon roka neće biti pregledani, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (*onlajn*) i na veb stranici Nacionalne kancelarije revizije. Rok za podnošenje dokumentacije je **16.09.2025. u 16:00 časova**.

Obrasci za prijavu mogu se uzeti na recepciji OAG-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na www.zka-rks.org i podneti Odseku za upravljanje dokumentima na sledeću adresu: Naselje: Arberija, ul. “Ahmet Krasniqi” br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 časova, obrazac i prateća dokumentacija mogu se dostaviti i preko e-pošte na rekrutimi@oagks.org ili poštom. Za detaljnije informacije možete kontaktirati tel. br. 038/606-004, lok. 1025.

Napomena:
Prijava poslate poštom, koje nose poštanski žig sa datumom isporuke izvršenim poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće uzete u razmatranje.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare , lidhur me nenin 26 Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.1470 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS
për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:

Numri i referencës:

Grada:

Numri i pozitave:

Kohëzgjatja e emërimit:

Analist për Planifikim dhe Raportim

APR/ZKA/11-09/25

ZKA-Z3

Një (1)

Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Nën udhëzimet e drejtpërdrejta të drejtorit, kryen analiza të Ligjit për ndarje Buxhetore dhe analiza të të dhënave tjera, dhe të njëjtat ju dorëzon ekiyeve të auditimit dhe ekipit në auditimin e Raportit Vjetor të Auditimit;
- Mbledhë të dhënat e nevojshme për ekipet e auditimit, me theks të veçantë raportet periodike mbi buxhetin, të hyrat, shpenzimet dhe raportet tjera, si dhe kryen analizën dhe selektimin e të dhënave sipas nevojave të auditimit; Të njëjtat i dërgon te drejtori me një përmbledhje për nevoja të menaxhmentit;
- Në koordinim me përgjegjësin kryesor për hartimin e RVA-së, ndihmon ekipin e auditimit me analiza të ndryshme;
- Kryen edhe detyra të tjera nga mbikëqyrësi nga fusha përkatëse;
- Raporton në baza të rregullta, lidhur me rezultatet dhe ndikimin e punës.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridik ose administratë publike
- Përvoja profesionale: Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale në analiza, planifikim dhe raportim në fushën e ekonomisë dhe financave.
- Preferohet njohja e gjuhës angleze.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri të avancuara në fushën e analizave, planifikim dhe raportim;
- Shkathësi në këshillim dhe udhëzim të shënimeve analizuese;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatë:
Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:
Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **16.09.2025 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. “Ahmet Krasniqi” nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:
Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L